



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2019:230890

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05515119

C.nr.278/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, të cilin e përfaqëson Avokatura Shtetërore nga Prishtina, me autorizim N.K, kundër të paditurit E. L nga fshati .., Komuna e Vushtrrisë, me objekt kontesti pasurim pa bazë, me vlerë të kontestit 314.00 €, pas mbajtjes së seancës përgatitore dhe shqyrtimit kryesor me datë 27.03.2024, në prezencën e përfaqësuesit të paditëses dhe të paditurit, në pajtim me nenin 399 të LPK –së, në të njëjtën ditë (27.03.2024), mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pa bazuar kërkesëpadija e paditëses Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, me të cilën ka kërkuar që në emër të pasurimit të pabazë, të detyrohet i padituri E. L nga fshati .., Komuna e Vushtrrisë, t'ia kthej shumën prej 314.00 € (treqind e katërmbëdhjetë euro), për shkak të parashkrimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, të cilin e përfaqëson Avokatura Shtetërore nga Prishtina, me datë 12.06.2018, ka paraqitur padi kundër të paditurit E. L nga fshati .., Komuna e Vushtrrisë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet që në emër të pasurimit të pabazë, t'ia kthej shumën prej 314.00 € (treqind e

katërbëdhjetë euro). Ka shtuar se i padituri edhe pas vdekjes së paraardhësit-babait të tij A. L. me datë 06.10.2012, i cili kishte qenë përfitues i skemës pensionale, ka tërhequr mjete financiare në shumën prej 314.00 €.

Gjykata me datë 27.03.2024, ka mbajtur seancën përgatitore në të cilën i autorizuari i paditëses ka mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe ka theksuar se i padituri E. L pas vdekjes së të ndjerit A.L i cili ka qenë përfitues i skemës pensionale, ndërsa kishte autorizuar të paditurin për tërheqjen e pensionit të tij, A.L ka ndërruar jetë sipas shënimeve me *data*, ndërsa pas kësaj periudhe janë tërhequr mjete me 26.12.2012 në shumën prej 101 euro, si dhe 23.01.2013 në shumën prej 112 euro, ndërsa sipas tabelës së MPMS-së, shuma e tërësishme është tërhequr në vlerën prej 314 euro. Njëkohësisht palës së paditur i ka ofruar mundësinë që kthimin e mjeteve ta bëjë pagesë, me këste sipas mundësive të tij ekonomike, duke hequr dorë nga kamata dhe shpenzimet procedurale.

I padituri E. L e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses, duke theksuar se babai i tij A.L i cili ishte përfitues i skemës sociale, ka vdekur me datë *data*, ndërsa tërheqjen e mjeteve e ka bërë 3-4 ditë pas vdekjes së tij. Po ashtu ka theksuar se kjo lëndë është e vjetërsuar sepse është nga viti 2012, ndërsa tani është viti 2024. Ofertën e përfaqësuesit të paditëses për marrëveshje për ta paguar shumën me këste, nuk e ka pranuar për shkak të pamundësisë financiare. Në fund ka theksuar se ia lë në vendosje gjykatës sa i përket kërkesës së paditëses.

Lidhur me deklarin e të paditurit se lënda është vjetërsuar-parashkruar, përfaqësuesi i paditëses ka theksuar se ia lë në diskrecion gjykatës që të vendosë nëse kërkesëpadia është e parashkruar. Pas mbajtjes së seancës përgatitore dhe pasi që nuk kishte propozime për prova të tjera, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor dhe ka administruar provat si: Qarkullimi për llogari i datës 29.05.2018, i lëshuar nga NLB Banka, Fletë- tërheqja e datës 23.01.2013, Fletë- tërheqja e datës 26.12.2012, fletëkthesa e cila përmban ftesën për kthim të mjeteve prej të paditurit, lëshuar nga paditësja me datë 30.11.2016, Akti i pranimit të ftesës i datës 29.11.2016 dhe lista e personave obligues e dorëzuar nga paditësja bashkë me padi.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, shkresave të lëndës dhe deklarin e të paditurit, në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se kërkesëpadia e paditëses ndaj të paditurit, është e pa bazuar sepse e drejta e paditëses për kthimin e mjeteve, është parashkruar.

Deklarimin e te paditurit se lënda është vjetërsuar, gjykata e vlerësoi si të mjaftueshme për të konstatuar se kërkesëpadia e paditëses është parashkruar, pasi që i padituri për shkak të mosnjohjes së terminologjisë ligjore edhe pse nuk e ka shprehur fjalën “parashkrim”, gjykata vlerësoi se i njëjti me fjalën “vjetërsim”, është thirrur në humbjen e të drejtës së paditëses për të kërkuar përmbushjen e detyrimit në rrugë gjyqësore nga i padituri.

Fillimisht gjykata e mori parasysh parashkrimin e parashtruar nga i padituri, bazuar në nenin 341 par.3 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Me nenin 342 par.1 të Ligjit të lartcekur përcaktohet se *Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër*”.

Me nenin 352 i Ligjit të lartcekur përcaktohet se *“Kërkesat parashkruhen për pesë (5) vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit.”* Pasi që tek pjesa e LMD-së, ku rregullohet çështja e pasurimit të pabazë dhe kthimi i asaj që përfitohet pa bazë juridike, nuk përcaktohet ndonjë afat tjetër i parashkrimit, gjykata për llogaritjen e afatit u bazua në afatin e përgjithshëm prej 5 vitesh.

Në nenin 369 të LMD –së, është përcaktuar se *“Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”*, ashtu që gjykata në shkresat e lëndës nuk ka arritur që të vërtetojë ekzistimin e ndonjë prove relevante e cila do ta kishte ndërprerë parashkrimin e kërkesës së paditëses.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, gjykata konstatoi se padia e paditëses për kthimin e mjeteve është paraqitur pas afatit.

Rrjedhimisht nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga Fletë-tërheqja e datës 23.01.2013, e dorëzuar si provë nga paditësja, gjykata vërtetoi se i padituri tërheqjen e mjeteve të fundit prej 112.00 euro, e ka bërë me datë 23.01.2013, prej së cilës datë i ka lindur e drejta për të kërkuar kthimin e mjeteve, e po ashtu edhe nga kjo datë (23.01.2013) ka filluar të rrjedh edhe afati i parashkrimit prej 5 vitesh, ndërsa paditësja padinë për kthimin e mjeteve e ka paraqitur me datë 12.06.2018, pra pasi kanë kaluar më shumë se 5 vite.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se kërkesa e palës paditëse është përfshirë në parashkrimin shues (humbës), kjo referuar pretendimeve të lartcekurave të palës paditëse dhe kohës së dorëzimit të padisë në gjykatë, nga ku vërtetohet fakti se padia është parashtruar pas kalimit të afatit prej më shumë se 5 viteve, nga dita kur paditësja ka marrë dijëni për të drejtën e saj për të kërkuar kthimin e mjeteve nga i padituri.

Lidhur me ftesën e paditëses të datës 30.11.2016, për kthim të mjeteve prej të paditurit, gjykata vlerësoi se kjo thirrje për përmbushjen e detyrimit, nuk e ka ndërprerë afatin e parashkrimit, konform nenit 372 të LMD-së, ku përcaktohet se *“Për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton që kreditori ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin”*.

Meqenëse në rastin konkret kërkesëpadia e paditëses refuzohet si e pabazuar, kjo për shkak të ekzistimit të parashkrimit të së drejtës së paditëses, gjykata nuk ka dhënë vlerësimin e saj për pretendimet e tjera faktike, dhe për provat me të cilat do të vërtetoheshin pretendimet faktike, përveç atyre që i referohen rrethanave lidhur me (mos) ekzistimin e pretendimeve të palëve, për parashkrimin e kërkesës së paditëses.

Andaj gjykata ka gjetur si të bazuar pretendimin e të paditurit se në këtë rast kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesëpadisë së paditëses, ngase është ditur qartësisht se kur i padituri ka bërë tërheqjen e mjeteve të fundit (23.01.2013) dhe nga kjo datë ka filluar të rrjedh afati i parashkrimit prej 5 vitesh.

Përkitazi lidhur me vlerësimin e këtyre rrethanave, gjykata ka vlerësuar se paditësja ka humbur mundësinë që kthimin e mjeteve nga i padituri ta realizojë në rrugë gjyqësore.

Gjykata vendosi ta refuzoj kërkesëpadinë e paditëses në kuptim të dispozitave të cituara, sipas të gjeturave faktike të përshkruara më lartë.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mbështeti në nenin 450 të LPK-së, marrë parasysh se paditësja e ka humbur kontestin, ndërsa i padituri nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e duke u bazuar në nenin 143.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:230890  
Datë: 27.03.2024  
Numri i dokumentit: 05515119

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.278/18, me datë 27.03.2024

Gj y q t a r i  
Jeton Zymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij me shkrim, gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.